

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për projektin “Programi rural i furnizimit me ujë”, me objekt “Për auditimin e ligjshmërisë, dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare të projektit” për periudhën nga 01.01.2013 deri më 30.05.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 114 datë 15.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 529/7 datë 15.09.2014, dërguar Z. Benet Beci, Drejtor Ekzekutiv i FSHZH, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Fondi Shqiptar i Zhvillimit si Agjenci e Zbatimit të Projektit, të marrë masat për të zbatuar me përpikmëri, në kohë dhe në cilësi të gjitha angazhimet që rrjedhin nga Marrëveshjet e huasë për financimin e projektit “Projekti rural i furnizimit me ujë”, të miratuar me ligjin nr.9883, datë 28.02.2008, me ligjin nr.10080, datë 23.02.2009, me ligjin nr. 10407, datë 31.3.2013, dhe me ligjin nr.10408, datë 31.03.2011, në lidhje me mënyrën e raportimit të donatorët, ritmet e disbursimeve, për të realizuar objektivat dhe komponentët e projektit.

Deri në mbyllje të projektit

2. Nga auditimi konstatohet se, megjithëse Projekti ka nis zbatimin që në vitin 2008 dhe afati i përfundimit të tij është në dhjetor të vitit 2014, nga Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, është paraqitur kërkesa në Ministrinë e Financave si Huamarrës i kredisë, (me miratim nga donatori (KfW), për të shtyrë afatin e disbursimeve për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV” deri në 30 qershor 2017, por ende nuk ka një përgjigje zyrtare miratimi nga Ministria e Financave.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave, për të marrë masat e nevojshme për të siguruar në kohë dhe sipas parashikimeve në marrëveshjen e financimit të Projektit, miratimin e shtyrjes së afatit të disbursimeve, me qëllim fillimin e financimit të programit “Fondi i investimeve sociale SIF IV”, për rritjen e nivelit të disbursimeve nga Huaja në përmbushje të objektivave të projektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit konstatohet se, nuk ka kthyer përgjigje zyrtare (Drejtori Ekzekutiv), për masat e marra për zbatim e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm brenda afatit ligjor prej 20 ditësh, të përcaktuar në shkresën e dërguar nga KLSH nr.368/9, datë 10.09.2013.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të marrë masa për të kthyer përgjigje mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i projektit, brenda afateve të parashikuara në ligjin e KLSH nr.8720, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000.

Në vazhdimësi

4. Nga auditimi konstatohet se, punimet për ndërtimin e ujësjellësit skema Shtrezë, kanë përfunduar dhe objekti është marrë në dorëzim nga komuna Shishtavec, por nga verifikimi në terren ka rezultuar se, për arsye sociale ujësjellësi ende nuk është vënë në funksionim për popullatën, për pasojë nuk është realizuar objektivi i investimit të kryer në qarkun e Kukësit në fshatin Shtrezë, të komunës Shishtavec.

Për këtë rekomandojmë:

-Të merren masa të menjëhershme nga Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në bashkëpunim me komunën Shishtavec, për të zgjidhur problemet sociale të lindura në këtë zonë, me qëllim vënien sa më shpejt në funksionim të ujësjellësit për furnizimin me ujë në fshatin Shtrezë, të komunës Shishtavec të qarkut të Kukësit.

Menjëherë

5. Në zbatim të marrëveshjeve të financimit për projektin konstatohet se:

- Programi “Për zbatimin e projektit fondi i investimeve sociale IV”, megjithëse ka mbi 3 vjet që është firmosur, niveli i disbursimeve është në nivele shumë të ulëta dhe ecuria e disbursimeve nuk është bërë sipas grafikëve të përcaktuar në përputhje me marrëveshjen e veçantë të financimit, pika II.1 “Përgjegjësitë dhe grafiku kohor i kostos dhe i financimit”.
- Nga kredia prej 5 milionë euro, janë disbursuar në vlerën 387,131 euro ose në masën afërsisht 7.74% e pjesës së huasë së akorduar, ndërkohë që sipas grafikut të shlyerjes së huasë, Huamarrësi fillon shlyerjen në qershor të vitit 2014.
- Disbursimet e fondeve në dy vitet e para të zbatimit të projektit të cilat kanë qënë me ritme të ulëta. Për periudhën objekt auditimi është disbursuar 64.05% e shumave të kredive për Fazën I, II, SIF IV dhe KfË Grant, ndërsa disbursimet në total sipas donatorëve janë realizuar në masën 73.85%.
- -Nga 14 kontrata të lidhura me subjektet për fazën e dytë, janë zbatuar plotësisht 12 prej tyre ose në masën 86%. Nga 17,460,000 euro vlera sipas marrëveshjes të lidhur me FSHZH dhe KfË Frankfurt am Main, është financuar vlera prej 12,894,042 euro, ose në masën 73.85 %.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marrë masa për të rritur ritmet e disbursimeve në përputhje me programin e zbatimit të projektit, dhe sipas grafikëve të përcaktuar në përputhje me marrëveshjen e veçantë të financimit, pika II.1 “Përgjegjësitë dhe grafiku kohor i kostos dhe i financimit”.

Në vazhdimësi

6. Në zbatim të marrëveshjeve të financimit, konstatohet se nuk është realizuar mbledhja e kontributit për pjesëmarrje nga ana e komunave përfituese të investimeve. Sipas kontratave aktuale të lidhura janë realizuar kontribute të mbledhura në vlerën 112.4 milionë lekë, në krahasim me vlerën 114.4 milion lekë të parashikuar ose në masën 98.26% të fondeve të planifikuara për t`u mbledhur nga përfituesit.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marrë masa të menjëhershme për të mbledhur kontributet për pjesëmarrje nga njësitë vendore, të cilat janë të përfshira në skemat e ndërtimit të ujësjellësave, në zbatim të marrëveshjeve të veçanta të lidhura me përfituesit e këtyre investimeve në komuna.

Menjëherë

7. Bazuar në kontratën e lidhur me përfituesit e ujësjellësit të ndërtuar në zonën Postribë, Shkodër, konstatohet se nuk është mbledhur i gjithë kontributi nga komuna për pjesëmarrje, pasi nga shumica e parashikuar në vlerën 12.8 milion lekë, janë mbledhur fonde në vlerën 10.8 milion lekë, ose 84.4% e kontributit për t`u paguar nga komunat, duke rezultuar me një detyrim të pambledhur në vlerën 2 milion lekë.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit në zbatim të kontratës së investimit të ujësjellësit, të marrë masa të menjëhershme për të kërkuar që komuna Postribë, Shkodër, të planifikojë fonde nga buxheti i komunës për shlyerjen e detyrimit të prapambetur në vlerën prej 2,000,000 lekë, nga mbledhja e kontributit për pjesëmarrje për kontratën e lidhur me përfituesit e ujësjellësit të ndërtuar në zonën Postribë, Shkodër.

Menjëherë

8. Konstatohet se Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, nuk janë kryer inspektime në komunat përfituese të investimeve të parashikuara, për arsye se ndërtimet e ujësjellësave kanë pak kohë që kanë përfunduar, ose janë në periudhë garancie në këto zona, duke rënë ndesh me detyrimet e përcaktuara në nenin 5.3 të marrëveshjes së financimit për programin “Fondi i financimit sociale IV” nga kredia e KFW-së,.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marrë masa për të kryer inspektime në komunat përkatëse, menjëherë pas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve në ujësjellësat e ndërtuar në këto zona, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenin 5.3 të marrëveshjes së financimit për programin “Fondi i financimit sociale IV” nga kredia e KFW-së.

Në vazhdimësi

9. Nga auditimi i kontratave të punimeve për ndërtimin e ujësjellësave konstatohet se, nga Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ***për projektet me financime të huaja***, nuk janë përcaktuar kritere të qarta për përlogaritjen e fondit limit për zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, pasi në disa raste është konstatuar se janë përdorur dy standarte në vendosjen e çmimeve të referencës, përkatësisht janë aplikuar dhe çmime referuar manualit të çmimeve të miratuar, dhe çmimet sipas udhëzuesve të donatorit (KfË).

Për këtë rekomandojmë:

- Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të marrë masa në të ardhmen për të përcaktuar kritere të qarta për përlogaritjen e fondit limit për zërat e punime të parashikuara në preventiv që në fazën e fizibilitetit (studim e projektim) për projektet me financime të huaja.

Në vazhdimësi

10. Nga auditimi i kryer për zbatimin e kontrateve të ndërtimit të ujësjellësave u konstatua se, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) nuk janë shqyrtuar rastet kur çmimet e zërave të punimeve kanë qënë më të larta se çmimet referuese (në ato raste kur i janë referuar manualit të çmimeve), por rezulton se ky komision ka shqyrtuar dhe ka patur korrespondenca me ofertuesit vetëm për rastet kur janë konstatuar çmime më të ulëta me manualin e referencës.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të marrë masa në të ardhmen, për të kërkuar që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), të shqyrtojë të gjitha rastet duke shkëmbyer korrespondencë me ofertuesit pjesëmarrës në tender, jo vetëm për ato raste kur çmimet janë më të ulëta për zërat e punimeve, por dhe në ato raste që konstatohen çmime disa herë më të larta krahasuar me çmimet referuese të manualit të çmimeve të miratuara me VKM.

Në vazhdimësi

11. Nga auditimi i zbatimit të kontratës WS/LCB/2010 Lot 2.2 me Operatorin Ekonomik ██████ sh.p.k, rezulton se, nuk janë vendosur kapakët e pusetave në veprën e marrjes në ndërtimin e “Ujësjellësit të Postribës, Malsi e Madhe, Qarku Shkodër”.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marrë masa të menjëhershme për të vendosur kapakun e pusetës në veprën e marrjes në zbatim të kontratës ËS/LCB/2010 Lot 2.2 me Operatorin Ekonomik ██████ sh.p.k, për ndërtimin e “Ujësjellësit të Postribës, Malësi e Madhe, Qarku Shkodër”.

Menjëherë

12. Nga auditimi i punimeve të kryera në ndërtimin e “Ujësjellësit të Postribës, Malsi e Madhe, Qarku Shkodër”, rezultoi se në librezën e masave nuk janë pasqyruar disa zëra të punimeve të

ndërtimeve të realizuara nga Operatori Ekonomik [REDACTED] sh.p.k, dhe ndryshimet që janë bërë nuk janë paraqitur pranë FSHZH.

Për këtë rekomandojmë:

Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të kërkojnë nga Operatori Ekonomik [REDACTED] sh.p.k, të bëjë pasqyrimin e zërave të punimeve të ndërtimit të realizuara në librezën e masave dhe këto ndryshime të paraqiten pranë FSHZH, për ndërtimin e “Ujësjellësit të Postribës, Malsi e Madhe, Qarku Shkodër”.

Menjëherë

13. Nga auditimi i kryer në zbatimin e punimeve rezulton se Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, nuk ka kërkuar zbatimin e kushteve teknike për kontratë në punimeve në ndërtimin e “Ujësjellësit të Postribës, Malësi e Madhe, Qarku Shkodër, për të realizuar mbrojtjen e veprës së marrjes së ujit nga përmbytja, pasi nga rritja e nivelit të ujit nga shirat, ka patur përmbytje duke dëmtuar cilësinë e ujit të pijshëm për popullatën.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të marrë masa të menjëhershme për të kryer punime shtesë për mbrojtjen e veprës së marrjes së ujit nga përmbytja si rezultat i rritjes së nivelit të ujit nga shirat, në ndërtimin e “Ujësjellësit të Postribës, Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.

Menjëherë

14. Nga auditimi konstatohet se, ***Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit,*** nuk ka ndjekur punimet sipas projektit në ndërtimin e “Ujësjellësit të Postribës, Malsi e Madhe, Qarku Shkodër”, pasi nuk i është kërkuar shoqërisë [REDACTED] sh.p.k, për plotësimin e dhomës së klorinimit me pajisjet sipas projektit, duke vështirësuar matjen e cilësisë së ujit të pijshëm në rrjet.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të marrë masat të menjëhershme duke i kërkuar shoqërisë [REDACTED] sh.p.k, të përmbushë kërkesat kontraktuale duke bërë plotësimin e dhomës së klorinimit me pajisjet sipas preventivit, në ndërtimin e “Ujësjellësit të Postribës, Malësi e Madhe, Qarku Shkodër”.

Menjëherë

15. Në zbatim të kontratës së punimeve në ujësjellësin e fshatit Ploshtan, konstatohet se, nga ***Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit,*** nuk janë marrë masat e duhura për të zgjidhur problemet sociale të lindura në fshatin Ploshtan, Komuna Kala e Dodës, pasi nuk është lejuar shoqëria [REDACTED] sh.p.k., për të bërë rrethimin e burimit nr.3, për të përfunduar në kohë punimet në burimin nr.1, në ujësjellësin Ploshtan.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të marrë masat të menjëhershme për të bërë zgjidhjen e problemeve sociale në fshatin Ploshtan, Komuna Kala e Dodës dhe t'i kërkojë shoqërisë [REDAKTUAR] sh.p.k., të përfundojë punimet në burimin nr.1, si dhe të bëjë rrethimin e burimit nr.3, në ujësjellësin e fshatit Ploshtan.

Menjëherë

16. Në zbatim të kontratës së lidhur për punimet në nënprojektin Pilafë (Kabë), nga auditimi në terren i disa zërave të punimeve ka rezultuar se shoqëria “Alba Konstruksion” sh.p.k, ka patur të meta dhe mangësi në kryerjen e punimet, përkatësisht:

- Në nënprojektin Pilafë (Kabë), nuk është zbatuar kontrata pasi mungojnë kapakët e pusetave në pusetat e kontrollit PQ 54 dhe PQ 56;
- Nuk janë vendosur depozitat e klorit, në dhomën e klorinimit në nënprojektin Pilafë (Kabë) në zbatim të kontratës së lidhur;
- Në pusetën e shuarjes së presionit mungonte tubi i ventilimit me DN 90 mm me rrjet mbrojtëse nga insektet;
- Në rezervuarin e ujit rezulton se është dëmtuar porta metalike.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të marrë masa të menjëhershme, me qëllim funksionimin sa më të mirë të ujësjellësit dhe t'i kërkojë shoqërisë [REDAKTUAR] sh.p.k., të kryejë punime në përputhje dhe në zbatimin të kontratës së lidhur për nënprojektin Pilafë (Kabë), respektivisht:

- ***Të vendosë kapakët e pusetave në pusetat e kontrollit PQ 54 dhe PQ 56;***
- ***Të vendosë depozitën e klorit, në dhomën e klorinimit në nënprojektin Pilafë (Kabë) në zbatim të kontratës së lidhur;***
- ***Në pusetën e shuarjes së presionit mungonte tubi i ventilimit me DN 90 mm me rrjet mbrojtëse nga insektet;***
- ***Të rregullohet porta metalike e dëmtuar në rezervuarin e ujit.***

Mangësitë e konstatuara janë në kundërshtim me kushtet e kontratës me nr.Ref. ËS/LCB/2010/Lot.

Menjëherë

17. Nga auditimi i kryer në terren mbi disa zëra të punimeve të kryera nga ana e shoqërisë “[REDAKTUAR]” sh.p.k, u konstatuan të meta dhe mangësi përkatësisht:

- Nuk ka marrë masa për zëvendësimin e kapakut të pusetës së grumbullimit të ujit në veprën e marrjes së ujit nr.1, në ujësjellësin e fshatit Shëmri, komuna Mal Zi, Kukës;
- Në veprën e marrjes të ujit nr.1 në ujësjellësin e fshatit Oreshkë, komuna Shishtavec, rezulton se është dëmtuar rrethimi në pjesën jugore të tij në, gjatësinë rreth 40 ml;
- Gjithashtu rezulton shembje dheu në zonën afër veprës së marrjes së ujit.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të marrë masa e menjëhershme dhe t'i kërkojë shoqërisë [REDAKTUAR] sh.p.k, për të zbatuar projektet në përputhje me kontratat përkatësisht:

- Të bëjë zëvendësimin e kapakut të pusetës të grumbullimit të ujit në veprën e marrjes së ujit nr.1, në ujësjellësin e fshatit Shëmri, komuna Mal Zi, Kukës.*
- Të bëjë riparimin e rrethimit në veprën e marrjes të ujit nr.1 në ujësjellësin e fshatit Oreshkë, komuna Shishtavec, në rrethimin e pjesës jugore të tij, në gjatësinë rreth 40 ml.*
- Të eliminojë shembjen, në veprën e marrjes nr.1 në ujësjellësin e fshatit Oreshkë, komuna Shishtavec.*

Mangësitë e konstatuara janë në kundërshtim me kushtet e kontratës me Nr. WS/LCB/2010/Lot 3.2.

Menjëherë

18. Konstatohet se nga Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, nuk janë marrë masa për zgjidhjen e problemeve sociale në fshatin Shtrezë, komuna Shishtavec, për të bërë të mundur përdorimin e eficient të ujit të pijshëm, pasi aktualisht banorët e fshatit Shtrezë nuk marrin ujë nga ky ujësjellës.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në bashkëpunim me komunën Shishtavec, të marrin masat për zgjidhjen e problemeve sociale në fshatin Shtrezë, komuna Shishtavec, për të bërë të mundur përdorimin eficient të ujit të pijshëm.

Menjëherë

19. Nga verifikimi në terren i punimeve të kryera nga ana e shoqërisë [REDAKTUAR] sh.p.k., u konstatua se gjatë zbatimit të kontratave të ndërtimit të ujësjellësve, nuk janë kryer punimet në zërin “Mbjellje barit”, në përputhje me projektet, pasi rezulton se nuk është mbjelle barrë në të gjithë rezervuarët e ujit.

Për këtë rekomandojmë:

-Agjencia e Zbatimit të Projektit/Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të kërkojë mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit që të ndjekë punimet shtesë, dhe shoqëria [REDAKTUAR] sh.p.k, të marrë masat për të bërë mbjelljen e barit në të gjithë rezervuarët e ujit të ndërtuara nga ana e kësaj shoqërie, në përputhje me projektin dhe kontratën e lidhur.

Menjëherë

B. MASA ZHDËMTIMI

1. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i dëmit ekonomik në vlerën **2,609 Euro (me t.v.sh)**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbarimore, për Operatorin Ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k të cilën e ka përfituar më tepër për

punime të pakryera në tenderin me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit të Postribës, Malsi e Madhe, Qarku Shkodër”.

Menjëherë

2. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i dëmit ekonomik në vlerën **7,028 Euro (me t.v.sh)**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbarimore, për Operatorin Ekonomik [REDACTED] sh.p.k të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Melan, Ilnice, Greve, Trene, Pejke, Gjuraj dhe Pjeçe, rrethi Dibër”.

Menjëherë

3. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i dëmit ekonomik në vlerën **5,227 Euro (me t.v.sh)**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbarimore, për Operatorin Ekonomik [REDACTED] sh.p.k të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Kishavec, Ploshtan dhe Pilafe, rrethi Dibër”.

Menjëherë

4. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i dëmit ekonomik në vlerën **6,083 euro (me t.v.sh)**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbarimore, për Operatorin Ekonomik [REDACTED] sh.p.k të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Dardhë dhe Shkozë” qarku Shkodër.

Menjëherë

5. Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **3,122 euro (me t.v.sh)**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbarimore, për Operatorin Ekonomik [REDACTED] sh.p.k të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Midhë & Berishë, Bushat dhe Zagora” qarku Shkodër.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin nr.37, të Kodit të Punës, kërkohet nga titullari i FSHZH, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

“Vërejtje me shkrim për:

1. [REDACTED] me detyrë përgjegjëse e Njesisë Juridike dhe e Prokurimeve, pasi;
- Për projektet me financime të huaja, nuk janë përcaktuar kritere të qarta ligjore për përllogaritjen e fondit limit për zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, kjo ka sjellë si pasojë:

- në disa raste konstatohet se janë përdorur dy standarte në vendosjen e çmimeve të referencës;
- Janë aplikuar si çmime duke ju referuar manualit të çmimeve të miratuara për periudhën përkatëse, si dhe janë referuar dhe çmimet sipas udhëzuesve të donatorit (KfW).

-Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në ato raste kur i janë referuar manualit të çmimeve, nuk kanë shqyrtuar rastet kur çmimet e zërave të punimeve të ofruara nga ofertuesit kur kanë qënë shume më të larta se çmimet referuese por ky komision ka shqyrtuar dhe ka patur korrespondenca me ofertuesit vetëm për rastet kur janë konstatuar çmime më të ulëta se manuali referencës.

2. ■■■■ me detyrë jurist/Specialist Prokurimesh, pasi:

- *Për projektet me financime të huaja*, nuk janë përcaktuar kritere të qarta ligjore për përlogaritjen e fondit limit për zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, kjo ka sjellë si pasojë:

- në disa raste konstatohet se janë përdorur dy standarte në vendosjen e çmimeve të referencës;
- Janë aplikuar si çmime duke ju referuar manualit të çmimeve të miratuara për periudhën përkatëse, si dhe janë referuar dhe çmimet sipas udhëzuesve të donatorit (KfW).

-Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në ato raste kur i janë referuar manualit të çmimeve, nuk kanë shqyrtuar rastet kur çmimet e zërave të punimeve të ofruara nga ofertuesit kur kanë qënë shume më të larta se çmimet referuese por ky komision ka shqyrtuar dhe ka patur korrespondenca me ofertuesit vetëm për rastet kur janë konstatuar çmime më të ulëta se manuali referencës.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Luljeta Shtylla, Skënder Muça, Lavdie Fshazi, Almen Alemi, Elira Cukalla më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT